

VENDIM
Nr. 767, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1134, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKINË TIRANË DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 760 634 149 (shtatëqind e gjashtëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore (RSU nr. 1 (nr. 15–18–19) nr. 20–21; nr. 22–23", në RSU nr. 1 shkolla "Dritas", në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar, përkatësisht, sipas detajimit të mëposhtëm, për:

a) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 15), në vlerën 106 099 202 (njëqind e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dy) lekë pa TVSH;

b) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 19), në vlerën 10 207 472 (dhjetë milionë e dyqind e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

c) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 18), në vlerën 236 807 314 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e shtatë mijë e treqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH;

ç) rikonstruksionin e godinave nr. 20–21, nr. 22–23, në vlerën 277 522 999 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

d) ndërtimin e shkollës 9-vjeçare "Dritas", në vlerën 129 997 161 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH."

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku